



KOMISIONI EVROPIAN HEQ TË GJITHA MASAT FINANCIARE NDAJ KOSOVËS



Bashkimi Evropian i ka hequr të gjitha masat ndëshkuese të vendosura ndaj Kosovës në qershor të vitit 2023, ka bërë me dije Komisioni Evropian. Gjatë debatit që është zhvilluar për Raportin për Kosovën në

Parlamentin Evropian, Jiri Plecity, përfaqësues i KE-së, konfirmoi heqjen e masave financiare. "Mund të konfirmoj se Komisioni Evropian e ka liru- ar të gjithë ndihmën financiare që më parë ishte nën masa dhe,

gjithashtu, po planifikojmë të riangazhohemi plotësisht me homologët tanë në Kosovë në mënyrë që ta rikthejmë Kosovën në rrugën e duhur në agjendën e saj të BE-së", ka thënë Plecity

OPINION

POLITIKA APO ZHVILLIMI: PSE KOSOVA ENDE PO MBETET PENG I KRIZAVE POLITIKE? F. 7

Shkruan: Nazmi JUSUFI

AKTUALE



ORAV EMËROHET AMBASADOR I BE-së NË TURQI F. 5

PSD-ja REALIZON AKSION: PROKURORI I SHTETIT, I KAPUR NGA VV-ja F. 6

EKONOMI



THEMELORJA KONFIRMON AKTAKUZËN NDAJ ISH-MINISTRES HAJDARI PËR REZERVAT SHTETËRORE F. 8

KOMPANITË NGA KOSOVA MARRIN PJESË NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR "PROWEIN" NË GJERMANI F. 8

SPORT



FERIZAJ DHE DRENICA SHËNOJNË FITORE TË MËDHA F. 11



SHBA-ja DHE BRITANIA MIRËPRESIN MARRËVESHJEN PËR LIGJIN PËR TË HUAJT, PËRMENDIN NEVOJËN E KONSULTIMIT ME KOMUNITETIN SERB F. 3

KUSARI-LILA: ÇMIMET E NAFTËS PRITET TË STABILIZOHEN NË VERË F. 6



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

A MUND TË BËHET NGUSHTICA BAB AL-MANDAB FRONTI I RI I LUFTËS NË IRAN?

TEHRAN, 17 MARS - Mbyllja efektive e Ngushticës së Hormuzit nga Irani, si përgjigje ndaj fushatës masive bombarduese të Shteteve të Bashkuara dhe Izraelit, ka shkaktuar tronditje në tregjet botërore të energjisë dhe ka bërë që çmimet e naftës të rriten. Situata mund të përkeqësohet edhe më shumë, thonë ekspertët, nëse ndërpritet edhe kalimi përmes Ngushticës Bab al-Mandab, që është një tjetër rrugë kyçe detare në Lindjen e Mesme. Një pikë e ngushtë strategjike pranë brigjeve të Iranit, Ngushtica e Hormuzit e lidh Gjirin Persik me oqeanin dhe tregjet globale përmes Gjirit të Omanit dhe Detit Arabik. Po ashtu, Bab al-Mandab është një kalim i ngushtë për anijet që hyjnë ose dalin nga Deti i Kuq, ndërkaq pjesa më e madhe e bregdetit të Jemenit kryesisht kontrollohet nga rebelët Huthi, një grup i armatosur që mbështetet nga Irani. Rebelët Huthi, që janë shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe që më herët kanë sulmuar anijet ndërkombëtare në Ngushticën Bab al-Mandab dhe në Detin e Kuq - një nga aleatët më të fuqishëm të Teheranit - deri më tani nuk janë përfshirë në luftën e ShBA-së dhe Izraelit kundër Iranit. Nëse ata përfshihen në konflikt, sipas ekspertëve, tregjet e energjisë do të përballen me më shumë tronditje. “Rreziku nga rebelët Huthi është

real”, tha Gregory Brew, historian i naftës iraniane dhe analist i lartë në Grupin e Euroazisë. Nëpër Ngushticën Bab al-Mandab kalon rreth 6 për qind e tregtisë botërore të naftës, që transportohet përmes detit, sipas administratës amerikane për Informacion të Energjisë. Arabia Saudite, eksportuesja më e madhe në botë e naftës, ka ndryshuar rrugën e miliona fuçi naftë nga Gjiri Persik drejt Detit të Kuq përmes tubacionit të saj Lindje-Perëndim, që kur ka nisur lufta më 28 shkurt. “Ka një numër të madh cisternash që tani po kalojnë transit nëpër Detin e Kuq për të marrë naftë të papërpunuar” nga porti saudit në Detin e Kuq, Janbu, që është rruga e vetme tjetër e eksportit të naftës për këtë shtet, tha Brew. “Kjo është shumë e rëndësishme për tregjet e naftës sepse lehtëson presionin që do të krijohej nga mbyllja e plotë e Gjirit Persik”. “Por, nëse rebelët Huthi do ta sulmonin Janbunin dhe nëse do të bënin mjaftueshëm për t’i ndërprerë eksportet nga terminali, atëherë do të përballëshim” me një ndërprerje prej rreth 7 milionë fuçish naftë në ditë, tha Brew.

“Gishtat në këmbëz”

Rebelët Huthi nuk kanë bërë ndonjë njoftim zyrtar për bashkëngjitjen në luftën në Iran. Por, udhëheqësi i grupit Abdul Malik al-Huthi, tha se rebelët

ishin të gatshëm të nisnin sulme në çdo kohë, nëse e vlerësojnë se duhet të veprojnë kështu. “Sa i përket përshkallëzimit ushtarak dhe veprimet, gishtat tanë janë në këmbëz në çdo moment, nëse zhvillimet e kërkojnë këtë”, tha ai në një fjalim televiziv më 5 mars. Agjencia gjysmëzyrtare iraniane e lajmeve, Fars, njoftoi më 12 mars se rebelët Huthi ishin në gatishmëri të plotë dhe mund të bashkoheshin me përpjekjet luftarake të Teheranit. Fars paralajmëroi se përfshirja e rebelëve jemenas në luftë mund të çojë në mbylljen e Ngushticës Bab al-Mandab. Është e paqartë nëse mungesa e rebelëve Huthi në luftën në Iran është e qëllimshme apo është shenjë e dobësisë aktuale të grupit. Në vitet e fundit sulmet ajrore amerikane dhe izraelite kanë shkatërruar kapacitetet luftarake të rebelëve Huthi. Sulmet ishin në përgjigje të sulmeve të rebelëve me dronë dhe raketa ndaj Izraelit dhe tregtisë ndërkombëtare në Detin e Kuq. Në maj të vitit 2025 grupi nënshkroi një marrëveshje armëpushimi me ShBA-në. Rebelët Huthi janë një anëtar kyç i asaj që Irani e quan bosht të rezistencës, rrjeti i tij i bashkëpunëtorëve dhe grupeve luftarake kundër armikut të përbetuar, Izraelit. Por, ekspertët thonë se rebelët Huthi ruajnë një autonomi të konsiderueshme dhe Irani ka kontroll të kufizuar



mbi veprimet e grupit. Një tjetër anëtar i boshtit, grupi militant libanez, Hezbollah, ka hapur një front të dytë në luftë, duke lëshuar raketa dhe dronë drejt Izraelit. Një gjë e tillë ka nxitur një përgjigje shkatërruese ushtarake nga Izraeli, i cili ka dërguar trupa tokësore në Liban dhe ka kryer një fushatë vdekjeprurëse ajrore. “Mendoj se situata financiare dhe ushtarake e rebelëve Huthi do t’i dekurajojë që të përfshihen në armiqësi në shkallë të gjerë”, tha Brew. “Fushatat e ShBA-së dhe Izraelit kanë shkaktuar dëme reale në pozicionin e rebelëve Huthi në Jemen. Ata po përballen me vështirësi për t’i paguar luftëtarët e tyre”. Por, Ahmed Nagi, analist i lartë për Jemenin në Grupin Ndërkombëtar të Krizave me seli në Bruksel, tha se vendimi i rebelëve Huthi për të mos u përfshirë në luftë është një lëvizje e llogaritur dhe e koordinuar me

Iranin. “Në vend se të aktivizohet në të gjitha frontet përnjëherësh, Irani duket se po e menaxhon përshkallëzimin gradualisht dhe po i mban rebelët Huthi si opsion rezervë”, tha Nagi. “Në këtë kuptim, rebelët Huthi funksionojnë si një kartë e rëndësishme që mund të luhet më vonë, veçmas duke pasur parasysh aftësinë e tyre për të penguar trafikun në Detin e Kuq dhe për të bërë presion më të gjerë ekonomik dhe në aspektin e sigurisë”. Nagi tha se mendon se mbajtja e rebelëve Huthi jashtë luftës e ruan këtë avantazh. “Nëse presioni ushtarak ndaj Iranit rritet ose nëse lufta hyn në një fazë më kritike, rebelët Huthi mund të ndërhyjnë pavarësisht koston që mund të kenë në frontin e brendshëm në Jemen”, tha ai. “Prandaj, frenimi i tyre aktual duket më shumë i planifikuar sesa hezitim për t’u përfshirë”.

IZRAELI PRETENDON SE E KA VRARË SHEFIN IRANIAN TË SIGURISË, ALI LARIJANI

JERUSALEM, 17 MARS - Ministri i Mbrojtjes i Izraelit, Israel Katz, ka pretenduar të martën se shefi i sigurisë i Iranit, Ali Larijani, është vrarë në një sulm ajror në Teheran. Ende nuk është publikuar asnjë provë që e vërteton këtë pretendim. Nëse konfirmohet, atëherë Larijani do të jetë figura më e lartë shtetërore që vritet pas vrasjes së liderit suprem të Iranit, Ali Khamenei, më 28 shkurt, në ditën e parë të sulmeve ajrore të forcave ushtarake amerikane dhe izraelite kundër Iranit. Irani ka bërë përpjekje që ta hedhë poshtë këtë deklaratë, duke e publikuar atë që është thënë të jetë një dorëshkrim i Larijanit i 17 marsit. Fotografia e dorëshkrimit të tij është publikuar edhe në llogarinë e Larijanit në “X”. Lajmi për Larijanin ka ardhur pasi ushtria izraelite ka pretenduar se e ka vrarë edhe



Gholamreza Soleimanin, komandantin e forcës paramilitare të Iranit, Basij, në valën e njëjtë të sulmeve ajrore ndaj Teheranit më 16 mars. Kjo deklaratë nuk është mohuar dhe as konfirmuar nga autoritetet iraniane. Zyra e kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu e ka

publikuar një fotografi të udhëheqësit shtetëror me përshkrimin: “Kryeministri Benjamin Netanyahu urdhëron eliminimin e figurave të larta të regjimit iranien”. Ofensivës amerikano-izraelite ndaj Iranit, tashmë në javën e tretë, nuk duket se do t’i ulët intensiteti, pasi sirenat ajrore

janë dëgjuar në disa lokacione të Lindjes së Mesme më 17 mars. Ushtria izraelite ka thënë se është duke shënjestruar “infrastrukturën e regjimit iranien” në valën e fundit të sulmeve nëpër Teheran, si dhe qendrat e lidhura me grupin Hezbollah, të përkrahur nga Irani, të cilin Shtetet e Bashkuara e kanë shpallur organizatë terroriste. Ndërkohë, Irani ka vazhduar të lëshojë raketa dhe dronë nëpër Lindje të Mesme, duke pasur në shënjestër edhe Izraelin. Ngushtica e Hormuzit - nëpër të cilën kalon një e pesta e transporteve botërore të naftës - vazhdon të jetë e mbyllur për shkak të sulmeve kundër anijeve. Një dron iranien dhe një raketë është raportuar ta ketë shënjestruar Ambasadën Amerikane në Bagdad, sipas zyrtarëve të sigurisë, njëri prej të

cilëve i ka thënë agjencisë së lajmeve AFP se “të paktën një dron” është rrëzuar në kompleksin e ambasadës. Një dron iranien e ka goditur edhe kompleksin e naftës Fujairah në brigjet e Emirateve të Bashkuara Arabe, duke shkaktuar zjarr, por jo të plagosur, kanë thënë autoritetet lokale më 17 mars. Për shpërthime është raportuar edhe në Doha, ndonëse Katari ka arritur t’i rrëzojë raketat në ajër. Presidenti amerikan Donald Trump u ka bërë thirrje shteteve në gjithë botën që të ndihmojnë në rihapjen e rrugëve detare për transport të naftës, por disa shtete veç kanë shprehur hezitim. Sulmet e Iranit ndaj shteteve lidere për prodhim të naftës së papërpunuar nëpër rajonin e Gjirit kanë ndikuar në rritjen e ndjeshme të çmimeve të energjisë në shumë shtete.

Shqipëria shpall Iranin shtet sponsor të terrorizmit

TIRANË, 17 MARS - Kuvendi i Shqipërisë e miratoi të martën një rezolutë për shpalljen e Iranit “shtet sponsor i terrorizmit” dhe shtet që përdor mjete terroriste. Rezoluta u miratua me 79 vota për, një abstenim, ndërsa opozita nuk mori pjesë në seancë. Përmes kësaj rezolute, Shqipëria dënon veprimet e Republikës Islamike të Iranit që, sipas dokumentit, mbështesin dhe mundësojnë akte terrorizmi, operacione hibride dhe aktivitete destabilizuese në rajone të ndryshme të botës, si dhe shprehet solidaritet i plotë me vendet mike të Gjirit Arab dhe me Turqinë, të cilat janë shënjestuar ditët e fundit nga Irani. Përmes rezolutës dënohen edhe sulmet kibernetike të kryera kundër institucioneve të Shqipërisë, përfshirë sulmin e vitit 2022 ndaj infrastrukturës shtetërore dhe përpjekjet e fundit për ndërhyrje në sistemet e Kuvendit. Përmes këtij dokumenti Kuvendi i bën thirrje Qeverisë së Shqipërisë që t’i forcojë masat kombëtare dhe ndërkombëtare për ta luftuar terrorizmin e sponsorizuar nga shtetet dhe kërcënimet kibernetike si dhe të bashkëpunojë me vendet aleate. Qeverisë i kërkohet edhe ta shpallë menjëherë Gardën Revolucionare Islamike organizatë terroriste, kurse



Hezbollahun organizatë terroriste, si rrjetëzim të Republikës Islamike të Iranit, në linjë me veprimet e Shteteve të Bashkuara dhe disa fuqive të tjera.

SHBA-ja DHE BRITANIA MIRËPRESIN MARRËVESHJEN PËR LIGJIN PËR TË HUAJT, PËRMENDIN NEVOJËN E KONSULTIMIT ME KOMUNITETIN SERB



PRISHTINË, 17 MARS - Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Kosovë i ka thënë Radios Evropa e Lirë se mirëpret marrëveshjen e arritur në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian për zbatimin e Ligjit për të Huajt dhe ka theksuar se çdo ndryshim që prek komunitetin serb në Kosovë duhet të bëhet në konsultim me pjesëtarët e tij. “E përgëzojmë angazhimin e palëve në këtë çështje për të arritur zgjidhje të pranueshme për të dyja palët”, ka thënë një zëdhënës i Ambasadës në përgjigjen me shkrim për Radion Evropa e Lirë. Edhe Mbretëria e Bashkuar tha se mirëpret marrëveshjen e arritur në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian lidhur me zbatimin e Ligjit për të Huajt. Më 14 mars Qeveria e Kosovës u pajtua që të ofrojë leje të përkohshme qëndrimi dhe t’i njohë letërnjoftimet e pjesëtarëve të komunitetit serb që nuk janë të pajisur me dokumente të Kosovës në Ligjin për të Huajt dhe për Automjetet, që nisi të zbatohet nga 15 marsi. Vendimi u bë publik pas një takimi në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe të dërguarit të posaçëm të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Peter Sorensen. “Marrëveshja respekton kornizën ligjore të Kosovës, duke ofruar zgjidhje praktike që mundësojnë që të gjitha komunitetet të jetojnë, punojnë dhe studiojnë ligjërisht në Kosovë, pa ndërprerje të shërbimeve. Ne mirëpresim zotimin e kryeministrit Kurti për ta zbatuar ligjin dhe planet e tij të ardhshme që prekin komunitetin serb të Kosovës në koordinim të ngushtë me BE-në dhe komunitetin”, shkroi në “Facebook” ambasadori britanik në Kosovë, Jonathan Hargreaves. Dy ligjet, ai për të Huajt dhe ai për Automjete, nisen së zbatuari pjesërisht më 15 janar, fillimisht përmes një fushate informuese për procedurat dhe rregullat e zbatimit të tyre, ndërsa nga 15 marsi nisi zbatimi i plotë i tyre. Këto dy ligje kërkojnë që të gjithë ata që nuk kanë dokumente të Kosovës të pajisen me leje qëndrimi, ndërsa automjetet me targa të huaja nuk do të mund të qarkullojnë në Kosovë më gjatë se tre muaj ose vetëm në bazë të autorizimit. Por, pas vendimit të 14 marsit kjo nuk do të vlejë tani për tani për serbët e Kosovës pa dokumente të Kosovës, pasi ata kanë mundësi të marrin leje të përkohshme qëndrimi prej 12-muajsh si dhe të bartin si mjet identifikimi letërnjoftimet e lëshuara nga autoritetet serbe. Pas takimit me emisarin evropian, Kurti u zotua se ekzekutivi që ai udhëheq do ta vazhdojë punën për shkrirjen e plotë të sistemit arsimor dhe shëndetësor, që funksionon sipas sistemit të Serbisë, në sistemin e vetëm të Kosovës. Ai tha se është pajtuar për të mundësuar leje të përkohshme qëndrimi për punonjësit shëndetësorë dhe ata të arsimit, në mënyrë që serbëve lokalë të mos u mungojnë shërbimet bazë derisa Kosova t’i shkrijë ato plotësisht brenda sistemit të vet. Këto lehtësira janë mirëpritur nga BE-ja dhe nga Serbia. Shefja e diplomacisë evropiane Kaja Kallas tha se është e gatshme të ndërmjetësojë “së shpejti” një takim të nivelit të lartë në mes të Kosovës dhe Serbisë, pasi autoritetet e Kosovës mundësuan lehtësira të përkohshme për komunitetin serb në Ligjin për të huajt. Sipas saj, “është krijuar një momentum i ri për t’i çuar përpara marrëdhëniet në mes të BE-së dhe Kosovës dhe dialogun në mes të Prishtinës dhe Beogradit”.

Nënshkruhet kontrata për vazhdimin e punimeve në Spitalin e Ferizajt

PRISHTINË, 17 MARS - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka nënshkruar të martën kontratën për vazhdimin e punimeve në Spitalin e Ferizajt. Ministri Vitia theksoi se pas tejkalimit të shumë sfidave dhe vështirësive të trashëguara dhe të reja, me kontratën e re projekti do të finalizohet brenda 30 muajsh. “Ky është një projekt shumë i rëndësishëm për këtë rajon, që do të realizohet sipas standardeve më të larta të infrastrukturës spitalore, me një kosto prej 24 milionë eurosh”, tha ministri Vitia. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, uroi qytetarët e Ferizajt për këtë projekt të shumëpritur.





KOMISIONI EVROPIAN HEQ TË GJITHA MASAT FINANCIARE NDAJ KOSOVËS

Bashkimi Evropian i ka hequr të gjitha masat ndëshkuese të vendosura ndaj Kosovës në qershor të vitit 2023, ka bërë me dije Komisioni Evropian. Gjatë debatit që është zhvilluar për Raportin për Kosovën në Parlamentin Evropian, Jiri Plecity, përfaqësues i KE-së, konfirmoi heqjen e masave financiare. “Mund të konfirmoj se Komisioni Evropian e ka liruar të gjithë ndihmën financiare që më parë ishte nën masa dhe, gjithashtu, po planifikojmë të riangazhohemi plotësisht me homologët tanë në Kosovë në mënyrë që ta rikthejmë Kosovën në rrugën e duhur në agjendën e saj të BE-së”, ka thënë Plecity.

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 17 MARS - Bashkimi Evropian i ka hequr të gjitha masat ndëshkuese të vendosura ndaj Kosovës në qershor të vitit 2023, është bërë me dije nga Komisioni Evropian. Gjatë debatit që është zhvilluar për raportin për Kosovën në Parlamentin Evropian, Jiri Plecity, përfaqësues i KE-së, konfirmoi heqjen e masave financiare. “Mund të konfirmoj se Komisioni Evropian e ka liruar të gjithë ndihmën financiare që më parë ishte nën masa dhe, gjithashtu, po planifikojmë të riangazhohemi plotësisht me homologët tanë në

Kosovë në mënyrë që ta rikthejmë Kosovën në rrugën e duhur në agjendën e saj të BE-së”, u shpreh ai. Gjatë diskutimit në Parlamentin Evropian është shprehur keqardhje për vitin e humbur në Kosovë për shkak të ngërçit politik me të cilin u përball vendi gjatë gjithë vitit 2025. Raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian, Riho Terras, tha se paraliza politike në të cilin ishte Kosova kishte pasoja edhe në procesin reformues. “Është për të ardhur keq që pasiguria dhe ngërçi politik kanë ngadalësuar ndjeshëm reformat e nevojshme që Bashkimi Evropian pret nga aplikantët, të cilat janë

gjithashtu qartësisht jetike për vetë vendin. Ka qartësisht fusha në të cilat Kosova ka bërë regres të ndjeshëm gjatë vitit të kaluar”, tha raportuesi Terras. BE-ja vendosi masa ndëshkuese ndaj Kosovës më 2023. Masat kishin të bënin me pezullim të financimit dhe të takimeve dypalëshe midis zyrtarëve evropianë dhe përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës. Masat u vendosën si përgjigje për shkak të tensioneve në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe, pasi kryetarët shqiptarë të katër komunave në veri morën mandatin. Atëbotë pati edhe përplasje mes protestuesve serbë me forcat e

sigurisë, përfshirë me pjesëtarët e misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR. Ndërkaq nga Bashkimi Evropian është përmendur edhe marrëveshja për zbatimin e Ligjit për të Huajt. “Fundjavën e kaluar në Prishtinë, falë lehtësimit të BE-së, u gjet një rrugë përpara për zbatimin e Ligjit për të Huajt në Kosovë. Ne i mirëpresim hapat e ndërmarrë nga Kosova në lidhje me ruajtjen e sundimit të ligjit. Kjo do t’u mundësojë serbëve të Kosovës të vazhdojnë të banojnë, studiojnë dhe punojnë në Kosovë ligjërisht, sipas ligjit të Kosovës”, deklaroi Anne Kempainen nga Shërbimi i Jashtëm Evropian. Sipas përfaqësuesve evropianë, kjo marrëveshje është edhe një dëshmi se dialogu sjell rezultate. Më 14 mars Qeveria e Kosovës ka bërë me dije se do të ofrojë leje të përkohshme qëndrimi dhe do t’i njohë letërnjoftimet e pjesëtarëve të komunitetit serb që nuk janë të pajisur me dokumente të Kosovës siç parasheh Ligji për të Huajt dhe për Automjetet, që ka nisur të zbatohet nga 15 marsi. Ligji për të Huajt dhe ai për Automjete nisën të zbatohen

pjesërisht më 15 janar, fillimisht përmes një fushate informuese për procedurat dhe rregullat e zbatimit të tyre, ndërkaq nga 15 marsi kanë hyrë në fuqi plotësisht. Ligji për të Huajt u kërkon të gjithë banorëve që nuk kanë dokumente të Kosovës të pajisen me leje qëndrimi, ndërsa automjetet me targa të huaja nuk do të mund të qarkullojnë në Kosovë më gjatë se tre muaj, ose vetëm në bazë të autorizimit. Hyrja në fuqi e vendimit nuk do t’i prekë serbët e Kosovës për periudhë 12-mujore. Këto lehtësira janë mirëpritur nga BE-ja, Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe nga Serbia.

Oda Ekonomike e Kosovës mirëpret heqjen e masave financiare nga BE ndaj Kosovës

Oda Ekonomike e Kosovës ka përshëndetur vendimin e Komisionit Evropian për heqjen e të gjitha masave financiare që më parë pengonin qasjen e

PSD-ja REALIZON AKSION: PROKURORI I SHTETIT, I KAPUR NGA VV-ja

PRISHTINË, 17 MARS - "Prokurori i Shtetit, i kapur nga VV-ja". Kështu u tha të martën në aksionin e Partisë Socialdemokrate para objektit ku ndodhet zyra e Prokurorit të Shtetit.

Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka kritikuar ashpër Lëvizjen Vetëvendosje për, siç tha ai, kapjen e Këshillit Prokurorial

të Kosovës. Molliqaj tha se kjo është një lëvizje strategjike e LV-së për ta kontrolluar procesin e zgjedhjes së kryeprokurorit dhe rekrutimin e prokurorëve.

Ai paralajmëroi se zgjedhja e një presidenti të afërt me LV-në mund ta legjitimojë këtë kontroll dhe të ndikojë në emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Molliqaj bëri thirrje për reagim të shoqërisë dhe institucioneve për ta mbrojtur pavarësinë e organeve të drejtësisë. "Arsyeja kryesore pse Albin Kurti e do presidentin e vet është për ta zgjedhur kryeprokurorin për shtatë vjet. Organi i akuzës po i mungon; nuk po i kryen punë më policia, por po i duhet edhe prokuroria", tha ai.



KURTI MBAN TAKIM ME DREJTUESIT E QENDRAVE NË KOSOVË DHE MËRGATË, DISKUTOHET PËR ZGJEDHJET E BRENDSHME TË LV-së



PRISHTINË, 17 MARS - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka mbajtur mbledhje me drejtuesit e qendrave në Kosovë dhe mërgatë.

Në takimin me drejtuesit e qendrave dhe drejtueset e GVV-ve në Qendra, u diskutua për situatën politike në vend, me theks të veçantë për çështje organizative që ndërlidhen me përditshmërinë e punës së strukturave tona organizative.

"Viti 2026 është edhe vit zgjedhor brenda Lëvizjes Vetëvendosje! me ç'rast aktualisht jemi në fazën përgatitore, ku gjithandej lagjeve e fshatrave të vendit tonë, aktivistët që drejtojnë strukturat tona organizative, do të organizojnë procesin e brendshëm zgjedhor, duke freskuar e plotësuar pozicionet drejtuese e duke pasur përfshirje akoma më të madhe të

mbështetëseve tanë, duke i shërbyer kështu konsolidimit të strukturave tona në të tria nivelet drejtuese. Qendrat e Lëvizjes Vetëvendosje!, në Kosovë e Mërgatë dhe në përgjithësi strukturat tona organizative që nga lagjet e fshatrat, janë të gatshme për angazhim e punë krahas aktualitetit politik e organizativ, sikurse përherë", ka njoftuar Lëvizja Vetëvendosje.

ORAV EMËROHET AMBASADOR I BE-SË NË TURQI

PRISHTINË, 17 MARS - Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Kaja Kallas, ka njoftuar emërimet e reja në kuadër të delegacioneve të BE-së, ku përfshihet edhe largimi i Aivo Orav nga detyra në Kosovë. Sipas njoftimit të Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS), Aivo Orav është emëruar ambasador i Bashkimit Evropian në Turqi. Ai aktualisht shërben shëf i Zyrës së BE-së dhe përfaqësues i posaçëm i BE-së në Kosovë.

Orav do të marrë detyrën e re më 1 prill 2026.

Ai ka një përvojë të gjatë diplomatike, duke shërbyer më herët edhe si përfaqësues i përhershëm i Estonisë pranë Bashkimit Evropian.

Orav kishte marrë detyrën



drejtues i Zyrës së BE-së në Kosovë më 2 shtator 2024. Para

tij në Kosovë kishte shërbyer Thomas Szunyog.

HAXHIU PRITI NË TAKIM SHEFEN E ZYRËS SË KE-SË, THEKSOHET BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET EVROPIANE

PRISHTINË, 17 MARS - Kryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka pritur të martën në takim shëfen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, Mary Ann Hennessey. Në takim është diskutuar për zhvillimet politike në vend, bashkëpunimin me institucionet evropiane dhe rëndësinë e avancimit të reformave demokratike dhe të sundimit të ligjit.

Kryetarja Haxhiu theksoi përkushtimin e Kuvendit për



forcimin e institucioneve demokratike dhe për thellimin e bashkëpunimit me partnerët evropianë në rrugën e Kosovës drejt integritetit evropian.

institucioneve dhe bizneseve të Kosovës në instrumentet e Bashkimit Evropian për zhvillim ekonomik. OEK-u ka theksuar se ky hap i rëndësishëm hap rrugën edhe për realizimin e projekteve rajonale në fushat e energjisë, mbrojtjes së mjedisit, digjitalizimit dhe infrastrukturës lokale. "Ne vlerësojmë angazhimin e Komisionit Evropian dhe institucioneve

evropiane për t'i rikthyer vendit tonë rrugën drejt zhvillimit ekonomik dhe integritetit evropian. OEK mbetet e gatshme ta vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë për të siguruar një sektor privat të fuqishëm dhe perspektivëdhënëse në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë", thuhet në komunikatën e OEK-ut.

Shahini: Heqja e masave nga BE-ja, korrigjim i vonuar dhe dështim i institucioneve vendore

Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, e konsideron heqjen e masave nga Bashkimi Evropian korrigjim i vonuar i një padrejtësie ndaj

ekonomisë së Kosovës. "Por, fakti që vendi ynë u vendos nën masa ndëshkuese është dështim i qartë i institucioneve dhe i qasjes politike, që për interesa të ngushta rrezikuan ekonominë, bizneset dhe partneritetin me Bashkimin Evropian. AKB-ja kërkon llogaridhënie të menjëhershme dhe ndryshim të kursit politik, sepse ekonomia e



Kosovës nuk duhet të jetë më viktimë e vendimeve të papërgjegjshme", ka thënë Agim Shahini, kryetar i AKB-së.

POLITIKA APO ZHVILLIMI: PSE KOSOVA ENDE PO MBETET PENG I KRIZAVE POLITIKE?

Shkruan: Nazmi JUSUFI

Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, Kosova ka ndërtuar një arkitekturë institucionale formalisht demokratike dhe ka bërë hapa të rëndësishëm në konsolidimin e shtetit. Megjithatë, pavarësisht progresit në ndërtimin e institucioneve, vendi vazhdon të karakterizohet nga cikle të shpeshta krizash politike, polarizim të thellë partiak dhe një fokus të vazhdueshëm të elitave politike në rivalitetin për pushtet, shpesh në dëm të prioriteteve zhvillimore. Ky fenomen ka krijuar një paradoks të dukshëm: një shtet me potencial të konsiderueshëm ekonomik dhe demografik, por me një ritëm zhvillimi më të ngadaltë se sa mundësitë reale që ofron. Në analizë strukturore, një nga faktorët kryesorë që e shpjegon këtë situatë është karakteri i sistemit politik të Kosovës, i cili është ndërtuar mbi një pluralizëm të fortë partiak, por me një kulturë politike ende në tranzicion. Partitë politike shpesh funksionojnë më shumë si struktura të mobilizimit elektoral dhe të menaxhimit të pushtetit, sesa si institucione programore



që prodhojnë politika afatgjata zhvillimore. Si rezultat, debati politik dominohet nga konfliktet e brendshme, koalicionet e brishta dhe rivalitetet personale, ndërsa çështjet strategjike si zhvillimi industrial, transformimi ekonomik dhe modernizimi institucional shpesh mbeten në plan të dytë. Një faktor tjetër i rëndësishëm lidhet me strukturën institucionale dhe fragmentimin politik që shpesh e vështirëson krijimin e stabilitetit qeverisës. Në një sistem parlamentar me shumë parti, formimi i qeverive shpesh varet nga koalicione të ndërlikuara, të cilat nuk janë gjithmonë të qëndrueshme në afat të gjatë. Kjo situatë prodhon cikle të shpeshta krizash qeveritare, zgjedhje të parakohshme dhe tensione të

vazhdueshme politike, të cilat reduktojnë kapacitetin e institucioneve për të implementuar politika zhvillimore afatgjata. Në këtë kontekst, energjia institucionale shpesh kanalizohet në menaxhimin e krizave politike dhe jo në hartimin e strategjive të qëndrueshme ekonomike. Nga perspektiva ekonomike, pasiguria politike ka ndikim të drejtpërdrejtë në klimën e investimeve dhe në zhvillimin e sektorit privat. Investitorët, qofshin vendas apo ndërkombëtarë, kërkojnë stabilitet institucional, parashi-kueshmëri ligjore dhe konsistencë në politikat publike. Kur sistemi politik karakterizohet nga tensione të vazhdueshme dhe ndryshime të shpeshta në orientimin qeverisës, rritet

perceptimi i riskut ekonomik, gjë që kufizon investimet strategjike dhe ngadalëson procesin e zhvillimit ekonomik. Një dimension tjetër i rëndësishëm është edhe raporti mes politikës dhe administratës publike. Në shumë raste, politizimi i administratës ka reduktuar efikasitetin institucional dhe ka dobësuar profesionalizmin në sektorin publik. Kjo ndikon drejtpërdrejt në kapacitetin e shtetit për të implementuar politika komplekse zhvillimore, për të menaxhuar projekte infrastrukturore dhe për të ndërtuar një administratë moderne dhe funksionale. Megjithatë, përtej këtyre sfidave strukturore, Kosova disponon edhe disa avantazhe të rëndësishme strategjike. Popullsia e re, diaspora ekonomike dhe pozicioni gjeografik në një rajon që gradualisht po integrohet në strukturat europiane krijojnë potencial real për transformim ekonomik. Sfida kryesore qëndron në transformimin e energjisë politike nga një logjikë e konfliktit të përhershëm në një logjikë të bashkëpunimit institucional dhe të orientimit drejt zhvillimit.

Në perspektivë afatgjatë, stabiliteti politik dhe zhvillimi ekonomik nuk janë procese të ndara, por dimensione të ndërlidhura të ndërtimit të shtetit. Një sistem politik që arrin të prodhojë stabilitet institucional, transparencë dhe konsensus minimal mbi prioritetet strategjike mund të krijojë kushtet për një transformim më të shpejtë ekonomik dhe social. Në të kundërtën, nëse ciklet e krizave politike vazhdojnë të dominojnë jetën institucionale, rreziku është që potenciali zhvillimor i vendit të mbetet i pashfrytëzuar për një periudhë të gjatë. Prandaj, dilema mes politikës dhe zhvillimit në Kosovë nuk është thjesht një debat teorik, por një çështje thelbësore e orientimit strategjik të shtetit. E ardhmja e vendit do të varet nga aftësia e elitave politike dhe institucioneve për të kaluar nga një kulturë e konfrontimit të vazhdueshëm në një model të qeverisjes që vendos zhvillimin ekonomik, stabilitetin institucional dhe interesin publik në qendër të politikëbërjes. Vetëm në këtë mënyrë Kosova mund të kapërcejë ciklin e krizave politike dhe të hyjë në një fazë të re të konsolidimit shtetëror dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

KUSARI-LILA: ÇMIMET E NAFTËS PRITET TË STABILIZOHEN NË VERË



PRISHTINË, 17 MARS - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, tha se gjatë verës pritet të ketë stabilitet të çmimeve të naftës. Bota po përballet me rritje të çmimeve të naftës pasi Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli nisën luftën kundër Iranit më 28 shkurt. Nga kjo rritje është prekur edhe Kosova, vend që është importuese e derivateve të naftës. Që kur ka nisur lufta në Iran, çmimet e naftës në Kosovë janë rritur ndjeshëm dhe kanë arritur deri në 1.55 euro për litër. Për t'i mbajtur nën kontroll çmimet, më 4 mars Kusari-Lila mori vendim për vendosjen e masave mbrojtëse, duke caktuar fitimet maksimale të lejuara për

shitjen me shumicë dhe pakicë. Gjatë një deklarimi për gazetarë më 17 mars, Kusari-Lila u pyet se sa ka rezerva të naftës Kosova. Por, ajo tha se ky informacion mbetet për institucionet, duke theksuar se “situata është stabile” sa iu përket rezervave. “Në raport me rezervat e importuesve, gjegjësisht kompanive që merren me tregtimin e derivateve, jemi duke i përcjellë edhe rezervat. Nuk ka lëvizje, nuk ka rënje në rezervat e tyre. Do të thotë, ende është situatë e menaxhueshme dhe larg situatës së panikut”, tha ministrja Kusari-Lila. Ajo kujtoi se ShBA-ja ka lëshuar një pjesë të rezervës shtetërore për ta zbutur ndikimin në tregjet globale të energjisë, po shtoi se Kosova nuk ka ardhur deri në

këtë pikë dhe se industria dhe ekonomia e saj “nuk janë në atë nivel që janë të rrezikuara në masë të madhe”. Megjithatë, Kusari-Lila tha se është i pashmangshëm ndikimi i mëtejshmë i ngjarjeve në Lindjen e Mesme që po reflektojnë në çmimet e derivateve. “Ne do ta bëjmë maksimumin dhe jemi duke bërë. Nuk ka, të them, fluktim jashtë normales. Gjegjësisht masa e vendosur ka të bëjë me mbajtjen nën kontroll, por kontrolli brenda kësaj hapësire e cila po tregohet se po lëviz çmimi, por jo mbi të paimagjinueshmen ose në masë ku mund të ketë ndikim tepër serioz për të keq. Po e them që, sipas të gjitha informacioneve, mund të shkojë edhe në një periudhë kohore deri në

stabilitet. Këtu ne nuk jemi aktorë, ne jemi konsumues të rrethanave që po ndodhin atje. Por, po shpresojmë që sa më parë të ketë stabilitet. Parashihet në muajt në vijim, në veçanti në periudhën e verës, do të ketë stabilitet të çmimit”, tha ajo. Ministria Kusari-Lila tha se vetëm dy kompani nuk e kanë respektuar vendimin e marzhës. “Ka pasur dy kompani që kanë shkelur vendimin tonë dhe Inspektorati më ka informuar për të dyja kompanitë, të cilat kanë masën e parë gjobën, masën e dytë tërheqjen e licencës. Nuk ka ardhur te masa e dytë, pra janë ndalur te dënimi, te reagimi i Inspektoratit të Tregut”, tha ajo. Sipas vendimit të autoriteteve, marzha tregtare maksimale e

lejuar për shitje me shumicë është deri në 2 centë për litër, ndërsa me pakicë deri në 12 centë për litër. Teksa konflikti po vazhdon në Lindjen e Mesme, transporti detar përmes Ngushticës së Hormuzit ka rënë në mënyrë drastike. Rreth 20 për qind e sasisë së përgjithshme të naftës së lëngshme natyrore (LPG) që shfrytëzohet nëpër botë qarkullon përmes kësaj ngushtice. Presidenti amerikan Donald Trump e ka pranuar se do të ketë rritje të çmimeve të naftës, por ka vlerësuar se ky është “çmim i vogël” që duhet paguar në mënyrë që të eliminohet kërcënimi përthamor i Republikës Islamike.

OPOZITA SERBE NË KOSOVË, NISMË TË RE BASHKËPUNIMI

MITROVICË, 17 MARS - Uniteti, lufta për një pozitë më të mirë të komunitetit serb në Kosovë dhe perceptimi ndryshe i rrethanave politike. Këto janë disa nga arsyet përse iniciativat qytetare serbe “Rrënjët” dhe “Veriu për të gjithë”, si dhe partia politike Lëvizja Popullore Serbe nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi më 15 mars. Këto subjekte politike kanë këshilltarë në kuvendet komunale të Leposaviqit, Mitrovicës së Veriut, Zubin Potokut dhe Ranillugut. Një nga nënshkruesit e kësaj marrëveshjeje, njëherësh udhëheqës i iniciativës qytetare “Rrënjët”, Ivan Vučković, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se marrëveshja e bashkëpunimit nënkupton edhe mundësinë e veprimit të përbashkët të këtyre tri subjekteve politike në zgjedhjet e ardhshme. Aktualisht mbetet e paqartë nëse në Kosovë do të mbahen zgjedhjet e reja parlamentare, pasi Gjykata Kushtetuese e vendit vendosi një masë të përkohshme deri më 31 mars, duke pezulluar zbatimin e dekretit të presidentes Vjosa Osmani për shpërndarjen e Kuvendit, derisa ta shqyrtojë kushtetutshmërinë e këtij vendimi.

A ka vend për veprime të reja politike?

Zoran Saviq, nga organizata joqeveritare Aktiv në Mitrovicë të Veriut, thotë se çdo bashkëpunim midis partive opozitare serbe në Kosovë është i mirëpritur, me kusht që të ketë një qëllim dhe strategji të përbashkët. Por, sipas tij, mbetet të shihet nëse marrëveshja e fundit do të rezultojë në një alternativë më serioze politike në praktikë. “Ajo që është e sigurt, është se pluralizmi politik është shumë i nevojshëm në mesin e



komunitetit serb në Kosovë. Vetëm një front më i gjerë politik mund të përfaqësojë një kundërpeshë më serioze ndaj opsioneve ekzistuese nga komuniteti serb - nga njëra anë, Lista Serbe, të cilën Beogradi e sheh si adresën e vetme legjitime politike për serbët në Kosovë, gjë që nuk është absolutisht e vërtetë, dhe nga ana tjetër, partia e Nenad Rashiqit, të cilën institucionet e Kosovës e shohin si partneren e vetme nga komuniteti serb”, thotë Saviq për “Radion Evropa e Lirë”. Politikologu nga Beogradi, Ognjen Gogić, beson se një pjesë e opozitës serbe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi sepse llogarit në thirrjen e zgjedhjeve të reja. Por, ai është skeptik se në fund - nëse caktohen zgjedhje të reja - këto parti do të dalin me një listë të vetme të përbashkët. Ai kujton se në prag të zgjedhjeve të dhjetorit të vitit të kaluar nuk kishte ndonjë paraqitje të përbashkët të partive opozitare serbe apo iniciativave qytetare, por shton se ka hapësirë për veprime të reja politike. “Zgjedhjet kanë treguar tashmë se ka hapësirë që një pjesë e votuesve të votojnë për një ‘rrugë të tretë’”, thotë Gogić për “Radion Evropa e Lirë”. Lista Serbe, e cila ka

mbështetjen e Beogradit, fitoi nëntë nga dhjetë vendet parlamentare, të rezervuara për komunitetin serb, në zgjedhjet e 28 dhjetorit, ndërsa një vend e fitoi Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë e Nenad Rashiqit, i cili ka bashkëpunim të mirë me qeverinë e kryeministrit Albin Kurti dhe aktualisht është ministër për Komunitete dhe Kthim.

Kush mund t'i bashkohet aleancës së re?

Vučković, i cili është edhe këshilltar në Kuvendin Komunal të Leposaviqit, thotë se janë të hapur për bashkëpunim me organizata ose individë të tjerë politikë, por me përjashtim të atyre që kanë bashkëpunuar me Listën Serbe ose qeverinë e Albin Kurtit në të kaluarën. “Ne besojmë se uniteti mund të çojë në përparim. Ne nuk e nënshkruam këtë marrëveshje për të konkurruar me askënd, por duam të ofrojmë një perceptim ndryshe të kushteve politike. Nuk na intereson nëse kjo do të reflektohet në Listën Serbe apo në partinë e Rashiqit. Ne do të ofrojmë programin tonë, njerëzit tanë - kjo është e gjitha që na intereson”, thotë Vučković.

Ai shton se të gjithë nënshkruesit e marrëveshjes ruajnë individualitetin e tyre, por se veprimi i përbashkët është ende i mundur kur bëhet fjalë për interesa të rëndësishme të komunitetit serb. Millija Bishevac, që përfaqëson Lëvizjen Popullore Serbe, tha në një konferencë për medie më 15 mars, se marrëveshja për bashkëpunim me iniciativat qytetare “Rrënjët” dhe “Veriu për të gjithë” u nënshkrua për t'i ofruar komunitetit serb një alternativë, përkatësisht për të krijuar “politikë autentike”. “Për shumë vite, këtu është ndjekur politika e gabuar, e diktuar nga Lista Serbe, e cila gjithmonë ka pasur mbështetjen zyrtare të Beogradit dhe po na çon drejt shkatërrimit. Pikërisht për këtë arsye, kemi vendosur të nisim një proces të bashkimit të të gjithë atyre që mendojnë ndryshe”, tha ai.

A është e qëndrueshme politika e pavarur e serbëve të Kosovës?

Saviq thotë se një politikë që përpigjet të jetë e pavarur si nga Beogradi ashtu edhe nga Prishtina “ka logjikë”, por se është shumë e vështirë të arrihet në praktikë. Ai thekson

se Lista Serbe ka mbështetje të fortë politike dhe institucionale nga Beogradi dhe se, për këtë arsye, është e vështirë për t'iu kundërvënë asaj. “Përveç kësaj, prej vitesh është ndërtuar një narrativ se qytetarët - në këtë rast nga komuniteti serb - i sigurojnë kushtet themelore për ekzistencë nga buxheti i Republikës së Serbisë, vetëm falë faktit që Lista Serbe është në pushtet. Kjo gjë është absolutisht e pavërtetë. Nga ana tjetër, Nenad Rashiq ka gjithashtu mbështetje të konsiderueshme nga aktorë të caktuar politikë në Prishtinë, kështu që hapësira për opsionet politike që përpigjen të jenë të pavarura nga të dyja palët, është mjaft e ngushtë”, thotë Saviq. Megjithatë, ai shton se bashkimi i aktorëve politikë të opozitës është i nevojshëm dhe se ndryshimet në nivel lokal tashmë janë të vërejtshme - thjesht nga fakti se po dëgjohen zëra politikë që nuk janë nga Lista Serbe. “Unë besoj se kjo është e rëndësishme për një shoqëri që, të paktën në mënyrë deklarative, përpigjet për parime demokratike, sepse mungesa e debatit, dialogut dhe përbaljes së opinionëve të ndryshme mbi çështje që prekin komunitetin serb, është një nga arsyet kryesore përse ai ndodhet në një situatë katastrofike sot”, thotë Saviq. Gogić, në anën tjetër, thotë se tri subjektet politike që nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit, i koordinuan veprimet e tyre në nivel lokal, por se “aleanca nuk do të ketë kuptim nëse ato nuk shkojnë në zgjedhje së bashku”. “Ky është testi bazë. Këtu ngecën më herët, sepse kur ishte më e nevojshme, para zgjedhjeve, ndodhi një përçarje. Tani mbetet të shihet nëse kjo aleancë do të mbijetojë, po qe se ka zgjedhje në Kosovë”, përfundon Gogić.

LDK-ja nis riorganizimin në Prishtinë, aktivizon Kolegjiun e Degëve

PRISHTINË, 17 MARS - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka njoftuar anëtarësinë se, në kuadër të procesit të riorganizimit të brendshëm dhe në përpunje me autorizimet e dhëna nga Kuvendi i LDK-së, është rifunksionalizuar Kolegjiun i Degëve të Prishtinës si një mekanizëm i rëndësishëm për koordinim, vendimmarrje dhe forcim të strukturave tona në kryeqytet. Sipas njoftimit të LDK-së, Kolegjiun do të shërbejë si një platformë e përbashkët për harmonizimin e qëndrimeve

politike të LDK-së në çështjet që lidhen me kryeqytetin, duke siguruar qasje të unifikuar, të qëndrueshme dhe të përgjegjshme në përfaqësimin politik dhe institucional. “Në vijim të këtij procesi, së shpejti do të miratohen aktet normative të Kolegjiun, të cilat do të përcaktojnë qartë organizimin, kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të tij, në funksion të fuqizimit të strukturave tona, rritjes së efikasitetit dhe transparencës në veprimtarinë politike. Gjithashtu, së shpejti do të

mbahet një takim me asamblistët e LDK-së në Prishtinë, me qëllim të koordinimit të mëtejshëm të veprimit tonë politik në Kuvendin Komunal, si dhe në funksion të avancimit të qëndrimeve tona të përbashkëta. Në këtë kuadër, angazhimi ynë mbetet i përqendruar në zbatimin konsekuent të programit të LDK-së për Kryeqytetin, duke synuar përmirësimin e shërbimeve publike, zhvillimin urban të qëndrueshëm dhe rritjen e cilësisë së jetës për qytetarët e



Prishtinës”, ka njoftuar LDK-ja. Sipas kësaj partie, ky proces synon konsolidimin e mëtejshëm të LDK-së si alternativa kryesore e djathtë

dhe forcimin e përfaqësimit të tyre në kryeqytet, përmes një veprimi të koordinuar, të përgjegjshëm dhe të orientuar drejt rezultateve konkrete.

Kompanitë nga Kosova marrin pjesë në panairin ndërkombëtar “ProWein” në Gjermani

DYSELDORF, 17 MARS - Shtatë kompani nga Kosova: Stonecastle Vineyards & Winery L.L.C., Kosova Wine, Biopak, Dualos, Suhareka Verari, Bodrumi i Vjetër dhe AgroVita kanë marrë pjesë në panairin ndërkombëtar të industrisë së verërave dhe pijeve alkoolike “ProWein” që është mbajtur nga 15 deri më 17 mars në Dyseldorf të Gjermanisë. Pjesëmarrja e tyre është mbështetur nga Ministria e

Industirisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), e cila ka siguruar një hapësirë ekspozuese prej 70 m² për prezantimin e produkteve të kompanive vendore. Gjatë panairit kompanitë e Kosovës kanë paraqitur verërat dhe produktet e tyre të ndryshme para blerësve, importuesve dhe

profesionistëve të industrisë së verës nga e gjithë bota. Njëkohësisht kanë zhvilluar takime me kompani dhe përfaqësues të industrisë nga vende të ndryshme për t'i zgjeruar bashkëpunimet dhe për të depërtuar në tregje ndërkombëtare. ProWein konsiderohet një nga panairët më të mëdha globale në sektorin e verës, me mbi 4 000 ekspozues nga më shumë se 100

vende dhe mbi 42 000 profesionistë të industrisë, duke ofruar platformë të rëndësishme për promovimin e produkteve, krijimin e kontakteve dhe zgjerimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare. Pjesëmarrja e kompanive të Kosovës synon ta promovojë cilësinë e produkteve vendore dhe ta rrisë praninë e Kosovës në industrinë ndërkombëtare të verës dhe pijeve alkoolike.



THEMELORJA KONFIRMON AKTAKUZËN NDAJ ISH-MINISTRES HAJDARI PËR REZERVAT SHTETËRORE

PRISHTINË, 17 MARS - Gjykata Themelore në Prishtinë ka konfirmuar aktakuzën ndaj ish-ministres së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, dhe tre personave të tjerë, lidhur me dyshimet për keqpërdorimet me rezervat shtetërore. Zëdhënësja e Gjykatës Themelore, Mirlinda Gashi, tha për Radion Evropë e Lirë se gjykata i ka refuzuar “të pabazuara” kërkesat e avokatëve të të pandehurve lidhur me kundërshtimin e provave dhe hedhjes poshtë të aktakuzës të ngritur nga Prokuroria Speciale e Kosovës. Gjykimi për këtë rast nisi në fillim të vitit, kur më 13 janar u mbajt seanca fillestare. Kjo seancë u mbajt pasi një paraprake kishte dështuar të zhvillohej, pasi Hajdari nuk ishte paraqitur në gjykatë, duke pretenduar se nuk i

ishte dërguar ftesë. Ky pretendim i saj u kundërshtua nga gjykata, që tha se ftesën ia kishte dërguar Hajdarit përmes postës. Aktakuza për dyshime për keqpërdorime të rezervave shtetërore ndaj Hajdarit dhe tre të akuzuarve të tjerë u ngrit më 11 nëntor 2025. Ish-ministrja Hajdari, aktualisht deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, dhe dy zyrtarë të MINT-it, Irfan Lipovica dhe Hafiz Gara dyshohen se bashkëkryerje i kanë keqpërdorur detyrat zyrtare me qëllim që të përfitonin pasuri për persona të tjerë dhe i kanë shkaktuar buxhetit të Kosovës një dëm prej rreth 3 milionë eurove gjatë muajve shkurt dhe mars 2022. Ata dyshohet se asokohe kishin blerë një sasi vaji dhe një sasi gruri jashtë vendit, që nuk kishin arritur kurrë në Kosovë. Hajdari, Lipovica dhe Gara



dyshohen për kryerjen e veprave penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe zbulimi i fshehtësisë zyrtare. Ndërsa i akuzuari i katërt, afaristi Ridvan Muharremi, dyshohet për ndihmë në kryerjen e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar. Ngritjen e aktakuzës Hajdari kishte deklaruar se një veprim i tillë ishte “tendencë politike”

ndaj qeverisë së kryeministrit Albin Kurti. Lidhur me dyshimet për keqpërdorime të rezervave shtetërore, më 2023 tre persona u arrestuan, përfshirë Garën, drejtor i Departamentit të Rezervave Shtetërore dhe Lipovicën, drejtor i Departamentit për Integritet Evropian. Po atë vit në Ministrinë e

Industirisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më 2023 u kryen bastisje pas publikimit të audioincizimeve nga portali “Nacionale”, ku ishte pretenduar se një sasi vaji, e blerë në Poloni, dhe një sasi gruri, e blerë në Turqi, nuk kishin arritur kurrë. Atëbotë Hajdari deklaroi se blerjet për rezerva shtetërore ishin bërë në përputhje me ligjin, por nuk pati dhënë më shumë hollësi, megjë informacionet për to janë sekrete shtetërore. Më vonë ajo e akuzoi policinë se gjatë bastisjeve ka marrë në cilësinë e provave dokumente të klasifikuara si sekrete shtetërore. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, - që është ftuar nga Prokuroria si dëshmitar për këtë rast, por deri më tani nuk ka shkuar për të dhënë dëshmi - i ka dalë në mbrojtje Hajdarit, duke thënë se “nuk ka kurrfarë korrupsioni e keqpërdorimi”.

NJË I ARRESTUAR DHE KATËR NË KËRKIM PËR FAJDE, DYSHOHET SE SHKAKTUAN DËM RRETH 700 MIJË EURO

PRIZREN, 17 MARS - Gjatë një operacioni në Prizren është arrestuar një person, ndërsa katër të tjerë janë në kërkim nën dyshime për fajde, njoftoi Policia e Kosovës. I arrestuari dhe katër personat në arrati dyshohen se një viktime i kanë shkaktuar dëm afër 700 000.00 euro. B. K., Gj. K., E. K., E. K. dhe E. R., përveç për veprën penale të fajdesë, dyshohen edhe për veprën e detyrimit dhe privimit të



kundërligjshëm të lirisë. Autoritetet thanë se pesë të dyshuarit vazhdimisht e kanë detyruar viktimën që të paguajë shuma të ndryshme parash si interes për fajde, duke përdorur

“forma të ndryshme presioni dhe dhune”. Po sipas njoftimit, ata dyshohen se në raste të caktuara e kanë privuar viktimën nga liria, me qëllim që ta detyrojnë që të paguajë kamata të larta të fajdesë. “Dëmi i shkaktuar ndaj viktimës, sipas vlerësimeve fillestare, arrin shumën rreth 700 000.00 euro, ndërsa të dyshuarit dyshohet se kanë kërkuar edhe rreth 450 000.00 euro shtesë në emër të interesit të fajdesë”, u tha në

njoftim. Autoritetet thanë se gjatë operacionit të zhvilluar në Prizren u kontrolluan pesë lokacione. Të arrestuarit i është shqiptuar masa e ndalimit prej 48 orësh. Së voni autoritetet kanë ndërmarrë disa operacione kundër fajdeve. Vitin e kaluar Prokuroria Themelore në Prizren ngriti një aktakuzë ndaj gjashtë personave që dyshoheshin se kishin përfituar, përmes fajdeve, 1.4

milion euro dhe 21 banesa e lokale afariste. Sipas Kodit Penal të Kosovës, kushdo që gjendet fajtor për fajde mund të dënohet me gjobë dhe burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. Nëse kjo veprë penal shkakton humbje financiare për të dëmtuarin në shumë prej mbi 10 mijë eurosh dhe nëse kryesi ka përfituar pasuri po kaq, ai mund të dënohet me gjobë dhe burgim nga një deri në tetë vjet burgim.

Komuna e Rahovecit përfundon ndërtimin e sistemeve bio-septike

RAHOVEC, 17 MARS - Në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “Be Clean, Be Green”, komuna e Rahovecit ka përfunduar me sukses zbatimin e një ndërhyrjeje të rëndësishme mjedisore për përmirësimin e kushteve sanitare në gjashtë vendbanime rurale përmes ndërtimit dhe instalimit të sistemeve bio-septike për trajtimin e ujërave të zeza. Ky projekt është realizuar në partneritet ndërmjet komunës së Rahovecit (Kosovë) dhe

komunës së Haraqinës (Maqedonia e Veriut), në bashkëpunim me organizatat joqeveritare Green Art Center dhe Center for Understanding and International Cooperation (CUIC), në përputhje me kontratën nr. 2023/450-726. Vendbanimet përfituese përfshijnë: 1. Pataqan i Epërm; 2. Reti; 3. Polluzhë; 4. Pataqan i Poshtëm; 5. Pastasel; 6. Lagjja 1 - Rahovec (zona përfituese). Nga ky investim përfitojnë drejtpërdrejt rreth 3 500 banorë,

të cilët tashmë kanë qasje në një sistem të sigurt, modern dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e ujërave të ndotura. Rezultatet e arritura përfshijnë: Reduktim të ndotjes së ujërave nëntokësore dhe tokës bujqësore; Përmirësim të shëndetit publik dhe ulje të rrezikut nga sëmundjet ujë-bartëse; Eliminim të praktikave të derdhjes së ujërave të zeza në natyrë; Përmirësim të kushteve higjieno-sanitare për komunitetet përfituese;

Kontribut në përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG 6 - Ujë i pastër dhe kanalizim). “Përfundimi i këtij projekti shënon një arritje të rëndësishme për Komunën e Rahovecit dhe qytetarët e saj. Ky investim garanton kushte më të mira jetese dhe një mjedis më të pastër për gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme. Falënderojmë Bashkimin Evropian dhe të gjithë partnerët për mbështetjen dhe



bashkëpunimin e shkëlqyer”, ka thënë kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi. Ky projekt përfaqëson një hap konkret drejt përmirësimit të infrastrukturës mjedisore dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkufitar në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.

ERRËSIRA PAS SKENAVE TË FAMSHME URBANE TË ARTISTIT BRITANIK LS LOWRY

Piktori i njohur pëlqente ta quante veten njeri të thjeshtë që krijonte veprat e tij me materiale të thjeshta. Në vitin 1957, ai i tregoi BBC-së se si i ndërtonte nga imagjinata pikturat e tij për jetën urbane industriale dhe përshkroi vetminë që i frymëzonte ato.



Nga: **Greg MCKEVITT** / BBC
(titulli: *'I sensed an enormous inner desolation': The darkness behind British artist LS Lowry's famous city scenes*)

Kur Laurence Stephen Lowry vdiq më 23 shkurt 1976, në moshën 88-vjeçare, pak njerëz e dinin se ai kishte bërë një jetë të dyfishtë si mbledhës qirash me kohë të plotë, madje edhe pasi përshkrimet e tij të peizazheve industriale të mbuluara me blozë të Anglisë veriore, e kishin bërë një nga artistët më të dashur të Britanisë. Suksesi i erdhi vonë, por ishte i përcaktuar të mos e linte ta ndryshonte; madje refuzoi edhe titullin e kalorësit, sepse nuk donte që njerëzit të mendonin se ishte bërë sqimatar. Pjesën më të madhe të pasurisë së tij të madhe ia la një vajze të re e cila, kur ishte 13 vjeçe, i kishte shkruar duke i kërkuar këshilla se si të bëhej artiste.

Në vitin 1957, BBC realizoi një dokumentar të shkurtër ku Lowry shfaqej para telajos. Në

film zbuloi mënyrën se si punonte, shprehite e tij krijuese dhe pse pikturonte figurat e tij karakteristike si shkrepësa. "I shoh ashtu, prandaj i pikturoj ashtu - kaq është", tha ai. Megjithëse i pëlqente ta përshkruante veten si njeri të thjeshtë, naiviteti i dukshëm i veprës së tij ishte maskë që fshihte një kompleksitet të brendshëm dhe dekada të tëra të edukimit të thellë artistik.

Lowry ishte 69 vjeç kur u transmetua filmi i BBC-së, pasi ishte pensionuar nga puna e tij e përditshme pesë vjet më parë. Meqë nuk kishte asnjë fitim nga pikturat e tij deri në moshën 58-vjeçare, nuk është çudi që kishte nevojë për të ardhura të qëndrueshme. Puna e tij përfshinte ecjen nëpër zonat më të varfra të Salfordit dhe Mançesterit për të mbledhur pagesat nga qiramarrësit. Ishin po ato trotuare ku një shekull më parë kishin ecur Karl Marx dhe Friedrich Engels, kur kushtet e ashpra industriale ndihmuan në formësimin e ideve të tyre revolucionare. Salfordi ishte

gjithashtu Qyteti i vjetër i ndyrë [Dirty Old Town] në këngën folk të Ewan MacCollit, e bërë e famshme nga grupet The Dubliners dhe The Pogues.

Por, Lowry këmbëngulte se nuk kishte ndonjë arsye tjetër pse përqendrohej te muret e fabrikave të gazit dhe kanalet e vjetra, përveç faktit se ato kishin "diçka që më tërheq në sensin e pikturimit". Ai i tha BBC-së: "Nuk jam reformator shoqëror; nuk mendoj se ka propagandë në punën time. Unë thjesht pikturoj skenat që shoh". E vetmja gjë që e shqetësonte ishte se si ta përshkruante me vërtetësi jetën në hijen e fabrikave, depove dhe mullinjve të Anglisë.

Si është keqkuptuar

Historia romantike e origjinës se si Lowry u bë artist thotë se një ditë, në vitin 1916, ai humbi trenin. I tregoi John Readit, realizuesit të filmit të BBC-së, se si, pasi u gjend pa punë në një periferi të Mançesterit, rastisi në disa rrugë me shtëpi të

njëpasnjëshme në këmbët e një fabrike gjigante. Ndërsa vështronte skenën, e pushtoi dëshira për ta pikturuar dhe në atë moment vendosi të bëhej artist. Kur pas vdekjes së tij doli në dritë se ai kishte mbajtur për vite me radhë një punë të zakonshme ditore, disa kritikë e hodhën poshtë duke e quajtur "piktor i së dielës". E vërteta është se ai kishte studiuar pikturën dhe vizatimin për të paktën 20 vjet, duke ndjekur kurse në Shkollën e Artit në Mançester dhe në Shkollën e Artit në Salford.

Ashtu siç disa nga veprat e Picassos mund të duken të ashpra për syrin e painformuar, edhe pikturat e Lowryt mund të duken naive, por të dy artistët duhej së pari të zotëronin rregullat tradicionale përpara se të gjenin mënyra të reja për t'i thyer ato. Lowry nuk e duronte idenë që të konsiderohej artist amator. Një nga frymëzimet e tij më të mëdha ishte piktori Adolphe Valette, i cili mbërriti në Mançester në vitin 1906 për të dhënë mësim arti dhe për të

prezantuar impresionizmin francez në qytet. Pikturat e Valettes për jetën moderne industriale patën një ndikim të rëndësishëm në tematikën dhe stilin e hershëm të Lowryt. Edhe pse Lowry ishte piktor i talentuar i peizazheve, me kalimin e kohës realizoi gjithnjë e më pak të tilla. Ndoshta mendonte se ajo që shihte gjatë punës si mbledhës qirash ishte më urgjente dhe më mbresëlënëse.

Megjithëse Lowry identifikohet me peizazhet industriale të Lankashirit, skenat e tij kryesisht buronin nga imagjinata dhe jo nga realiteti i drejtpërdrejtë. "Filloj me një telajo bosh dhe preferoj të pikturoj nga syri i mendjes sime", tha ai. Fleta e bardhë nuk e frikësonte aspak. Edhe pse nuk kishte ide të paracaktuar se çfarë do të pikturonte, niste duke pikturuar ndërtesat dhe pjesa tjetër vinte vetë. "Ndonjëherë del shumë mirë dhe ndonjëherë, pa ndonjë arsye të dukshme, aspak mirë, por mund të duhen edhe disa vite për ta përfunduar një pikturë nga fillimi deri në fund.



Lowry pati vështirësi të shiste pikturat e tij për vite me radhë, por sot ato arrijnë miliona në ankande (Getty Images)

Natyrisht, janë piktura të ndërlikuara dhe plot me figura dhe detaje - gjithçka kërkon ekuilibër, dhe kjo nuk është e lehtë.

“Jam një njeri i thjeshtë”, tha njëherë Lowry, “dhe përdor materiale të thjeshta: të zeze fildishi, të kuqe të ndezur, blu prusiane, okër të verdhë, të bardhën e plumbit dhe i përziejë ato pa asnjë hollues - vetëm këto përdor për pikturat e mia”. Lowry nuk besonte në pritjen pasive të frymëzimit. Në filmin e shkurtër të vitit 1957, ai tha se piktura ishte zakon, pavarësisht nëse ishte apo jo në disponim për të. Ai nuk donte që krijimtaria e tij të turbullohej nga mendimi i tepërt. “Kam vënë re se kur jam shumë i shqetësuar që të bëj diçka mirë, nuk e bëj aspak mirë; dhe, kur nuk duket se më intereson shumë dhe asgjë nuk më shqetëson, atëherë del mirë”, tha ai.

Ai vazhdonte të punonte me këmbëngulje mbi një pikturë derisa të ishte i bindur se nuk mund të bënte më asgjë me të. Refuzonte të kufizohej nga nocionet e sakta të kompozimit qendror dhe perspektivës, shpesh duke zgjatur ose ngjeshur ndërtesat për të theksuar gjallërinë e turmave të tij si shkrepëse. “Në fund të fundit, është thjesht pikturë -

është trillim, nuk është realitet”, tha ai.

Filmi i shkurtër i BBC-së përdori një qasje që më pas u bë e zakonshme, duke ndërthurur narracionin e vetë Lowryt me skena ku ai shihej duke punuar. Pamjet u xhiruan në shtëpinë e Lowryt, plot me orë muri, në një fshat të gjelbëruar pranë Manchesterit, ku ai jetonte i vetëm. Producenti John Read kujtoi më vonë: “Pavarësisht figurës së tij disi të ngathët, ai kishte dinjitetin dhe qëndrimin e një zotërie. Por, kur e pashë ulur në atë dhomë, duke vështruar në zjarr ... ndjeva një shkretëtirë të madhe të brendshme te ky njeri”. Një vëzhgues i përjetshëm i jetës, veprat e Lowryt kapën melankolinë e turmave të mëdha. “Është e pashmangshme që të reflektoj veten time në figura - jam person shumë i vetmuar”, i tha ai BBC-së.

Lidhja me “njerëzit si shkrepëse”

Lowry fshihej pas një fasade të thjeshtë dhe tokësore, por kjo sjellje pa pretendime mund të ketë bërë që disa ta nënvlerësonin punën e tij si paaftësi. Kur u pyet pse pikturat e tij ishin të mbushura me kaq

shumë figura si shkopinj shkrepësesh, ai tha se zakonisht fillonte vetëm me disa, por “për hir të kompozimit”, në fund “përfundon me një pikturë plot njerëz”. Në filmin e vitit 1957 ai këmbënguli se nuk e kishte problem që njerëzit i quanin figurat e tij “njerëz si shkrepëse”, por në vitet e mëvonshme filloi ta shihte këtë si një mënyrë përçmuese për të përshkruar punën e një artisti të trajnuar. Megjithatë, ideja preku publikun britanik që blinte disqe kur dy vjet pas vdekjes së Lowryt, dueti muzikor Brian dhe Michael arriti vendin e parë në top-listat britanike, për tri javë, me këngën homazh Matchstalk Men and Matchstalk Cats and Dogs. Ky hit sentimental, me kor fëmijësh dhe ndryshim tonaliteti, përmban edhe një kthesë poetike: vargu “tani ai merr penelin dhe pret jashtë portave të fabrikës” shndërrohet në “portë perlash” në refrenin e fundit, duke aluduar për portat e parajsës.

Në të njëjtin vit kur BBC transmetoi filmin e shkurtër, Lowry mori një letër nga një vajzë 13-vjeçare, Carol Ann Lowry, e cila shkroi se, meqë kishin të njëjtin mbiemër, a kishte ai ndonjë këshillë se si ajo mund të bëhej artiste. Ai nuk iu përgjigj me letër, por disa muaj

më vonë u shfaq papritur në shtëpinë e saj në Roçdejl. Pas habisë fillestare për këtë burrë të panjohur në pragun e derës, ajo u bë një lloj vajze e adoptuar për të. Kur ai vdiq në shkurt 1976, në moshën 88-vjeçare, artisti i pamartuar ia la asaj pjesën më të madhe të pasurisë së tij.

Disa muaj pas vdekjes së tij, Akademia mbretërore organizoi një ekspozitë retrospektive të veprave të tij, e cila u prit me shumë vlerësime. Në katalogun e ekspozitës, poeti laureat John Betjeman shkroi se veprat e mbledhura të Lowryt do të rrëzonin çdo ide se ai ishte “thjesht një tjetër ‘primitiv’ autodidakt me pasion për arkeologjinë industriale”. Sipas tij, “mbi gjithë veprën e tij rëndon një melankoli kërcënuese. Ai është piktor i vetmisë”.

Megjithëse Lowry e çmonte vlerësimin që i sillte anëtarësimi në Akademinë Mbretërore, ai mbeti gjithmonë dyshues ndaj establishmentit artistik që përfaqësonte. Mbretëresha u përpoq ta nderonte Lowryn pesë herë - rast rekord - duke përfshirë një OBE [Urdhri i Perandorisë Britanike] në vitin 1955, një CBE [Komandant i Urdhrit të Perandorisë Britanike] në vitin 1961 dhe një titull kalorësi në vitin 1968, por

ai i refuzoi të gjitha. Sipas artistit Harold Riley, miku i tij i tha se kjo ndodhi sepse nuk donte të ndryshonte mënyrën se si njerëzit e shihnin, jo sepse kishte “diçka kundër sistemit”. Megjithëse për vite me radhë pati vështirësi të shiste pikturat e tij, sot ato shiten për miliona në ankande. Në vitin 2024, Pasditja e së dielës, një pikturë të cilën ai e përfundoi në të njëjtin vit kur BBC transmetoi filmin e shkurtër, u shit për gati 6.3 milionë paund [7.3 milionë euro]. Piktura e tij e vitit 1953, Duke shkuar në ndeshje, u shit edhe më shtrenjtë, për 7.8 milionë paund [9.1 milionë dollarë] dy vjet më parë. Në vitin 2000, hapja e Qendrës “Lowry” në Salford konfirmoi statusin e tij si një nga bijtë më të dashur të qytetit. I ndërtuar si pjesë e një projekti për rinovimin e kanalit të vjetër, kompleksi modern i teatrit dhe galerive me vlerë 106 milionë paundë [122 milionë euro], është bërë një nga atraksionet më të vizituara të zonës. Sot, Manchesteri dhe Salfordi kanë shumë pak ngjashmëri me botën që LS Lowry dikur pikturoi, megjithatë poezia që ai gjeti në atë që e quante “beteja e përditshme e jetës” vazhdon të jehojë ende te njerëzit.

/Telegrafi/



SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com





QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Ferizaj dhe Drenica shënojnë fitore të mëdha

FERIZAJ, 17 MARS - Ferizaj dhe Drenica kanë regjistruar fitore të mëdha në xhiron e 25-të të Superligës së futbollit. Ferizajasi e kanë mposhtur Prishtinën me rezultat të thellë 3:0 në “luftën” e tyre për t’iu

shmangur rënies nga liga. Nga ana tjetër, kriza e thellë e “bardhekaltërve” është duke vazhduar dhe pas kësaj humbjeje thuajse i kanë humbur gjasat për titull të kampionit. Me këtë rezultat Ferizaj është në vendin e tetë

me 29 pikë, ndërsa Prishtina në pozitën e tretë me 38 pikë. Edhe Drenica ka regjistruar fitore të madhe ndaj Malishevës me rezultat 4:2. “Kuqezinjtë” me këtë fitore vazhdojnë të shpresojnë që t’i ikin më së keqes - rënies

nga liga, kurse Malisheva e ka bërë një hap prapa vendeve që çojnë në Evropë. Me këtë rezultat Drenica renditet në vendin e nëntë me 28 pikë, kurse Malisheva gjendet në vendin e katërt me 37 pikë.



PRESIDENTI I FFK-së: BASHKËPUNIMI ME KFOR-in ITALIAN, I FRYTSHËM

PRISHTINË, 17 MARS - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e KFOR-it nga kontingjenti italian, Fabio Schiavone, Angela Scuccuglia dhe Guido Di Matteo, për të cilët ka thënë se gjithmonë janë të gatshëm për ta mbështetur punën e FFK-së. “Diskutuam për projektet që kemi nisur së bashku, përfshirë punën e bërë në Kampin e Batllavës. Ndërkaq, tani fokusi ishte rreth bartjes dhe vendosjes së kontejnerëve nga kazerma e FSK-së ‘Adem Jashari’ në kampin e futbollit në Bërrnicë, të cilët komandanti i FSK-së, gjeneral Bashkim Jashari, ka vendosur t’i dhurojë për FFK-në në shërbim të gjeneratave të



reja. Falënderova përfaqësuesit e KFOR-it italian për bashkëpunimin e vazhdueshëm me FFK-në dhe për mbështetjen që e japin përmes trupave ushtarake dhe

mjeteve të tyre teknike për t’u krijuar kushte më të favorshme rinisë dhe komunitetit në përgjithësi për zhvillimin e futbollit”, ka shkruar Ademi në rrjete sociale.

GODITJE PËR KOMBËTAREN E SHQIPËRISË, KONFIRMOHET MUNGESA E REY MANAJ NDAJ POLONISË

TIRANË, 17 MARS - Sulmuesi i Kombëtares shqiptare, Rey Manaj, nuk do të jetë në dispozicion të Shqipërisë për ndeshjen e rëndësishme ndaj Polonisë që zhvillohet më 26 mars në Varshavë. Lajmi është konfirmuar pas raportit mjekësor të publikuar nga klubi i tij turk, Sivasspor. Manaj do të mungojë në gjysmëfinalen e “play-off”-it për kualifikimin në Kupën e Botës 2026, një përballje shumë e rëndësishme për kuqezinjtë në rrugën drejt turneut botëror. Sipas njoftimit zyrtar të klubit turk, sulmuesi shqiptar ka pësuar një dëmtim serioz në pjesën e pasme të kofshës së majtë. Ekzaminimet mjekësore të kryera me rezonancë magnetike kanë konfirmuar një



MAQEDONIA E VERIUT ME 8 SHQIPTARË PËR KUALIFIKIMET VENDIMTARE TË BOTËRORIT 2026

SHKUP, 17 MARS - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Maqedonisë së Veriut në futboll, Goce Sedloski, ka publikuar listën e futbollistëve për ndeshjet e radhës në kuadër të kualifikimeve për Kupën e Botës. Në këtë listë janë përfshirë tetë futbollistë shqiptarë: Enis Bardhi, Visar Musliu, Ezgjan Alioski, Imran Fetai, Egzon Bejtullai, Reshat Ramadani, Isnik Alimi dhe Lirim Qamili. Lista e plotë përfshin tre portierë: Stole Dimitrievski, Dejan Iliev dhe Damjan Shishkovski. Në repartin e

mbrojtjes janë ftuar: Gjoko Zajkov, Darko Velkovski, Visar Musliu, Ezgjan Alioski, Andrej Stojčevski, Sebastian Herrera, Nikola Serafimov, Imran Fetai dhe Egzon Bejtullai. Në mesfushë janë përzgjedhur: Elif Elmas, Enis Bardhi, Boban Nikolov, Tiho Kostadinov, Reshat Ramadani, Isnik Alimi, Ljupče Doriev, Luka Stankovski dhe Jani Atanasov. Ndërsa në sulm janë përfshirë: Deni Musovski, Enis Rastoder, Bojan Miovski, Darko Çurlinov, Milan Ristovski, Aleksandar Trajkovski dhe Lirim Qamili. Me një kombinim të



lojtarëve me përvojë dhe prurjeve të reja, përfaqësuesja synon t’i vazhdojë paraqitjet

pozitive dhe t’i mbajë gjallë ambiciet për kualifikim në Botërorin 2026 në ShBA.

çarje të tendinit brenda muskullit të gradës “3c”, e shoqëruar gjithashtu me gjakderdhje në zonën e dëmtuar. Në raportin mjekësor të publikuar nga Sivasspori është thënë se “lojtari ynë është dëmtuar në pjesën e pasme të kofshës së majtë. Si rezultat i ekzaminimit me rezonancë të kryer sot, është konstatuar një çarje e tendinit brenda muskullit të gradës 3c dhe gjakderdhje në pjesën e pasme të kofshës së majtë”. Ky dëmtim konsiderohet serioz dhe pritet ta mbajë sulmuesin jashtë fushave për një periudhë të konsiderueshme, duke e përjashtuar automatikisht nga grumbullimi i radhës i Kombëtares së Shqipërisë.

Rashica do të largohet nga Beshiktashi

BESHIKTASH, 17 MARS - E ardhmja e Milot Rashicës nuk do të jetë te Beshiktashi, pasi klubi nga Turqia do ta nxjerrë në shitje futbollistin e Kosovës sapo të përfundojë sezoni aktual. Është

trajneri Sergen Yalcin ai që ka sugjeruar shitjen e Rashicës në verë pasi sulmuesi i krahut nuk ka arritur ta bindë deri më tani. 29-vjeçari nuk po ka minuta të shumtë pasi trajneri nuk e shih

si pjesë të projektit, dhe tashmë Beshiktashi është në pritje të ofertave për Rashicën. Që nga ardhja e trajnerit Yalcin, Rashica ka pasur shumë pak minuta të plota, duke u përfshirë vetëm

katër herë si titullar për 90 minuta. Në 28 paraqitje këtë sezon, Rashica ka 2 gola e 5 asistime, kurse me Beshiktashin ka kontratë deri në verën e vitit 2027.



NJOFTOJ

Bashkëpronarin tim me pjesën ideale **Ali (Gani) Mulla 1/3** , si blers I interesuar unë si bashkëpronar me parcelën : **P-71813068-08651-4 ZK Prizren** me pjesën time ideale të bashkëpronësisë **Ergin (Gani) Mulla 2/3** po shes pjesën time ideale në tërësi .

Sipas rregulloreve ligjore për shitjen e pasurive të palujtshme është e nevojshme që filimisht të ofrohet shitja bashkëpronarit cili ka të drejtën e parablerjës në rase bashkëpronari nuk e blen pjesën time ideale athere shitja mund të bëhet me blerës të tjerë .

Me këtë ofroj bashkëpronarin tim nëse ai është I interesuar të blej pjesën time ideale të lajmrohet Brenda **30** ditëve të paguaj cmimin total I blerjes ne shumën prej **150.000 €** duke paguar me para në dorë / me para të gatshme .

Kontakt Telefon : 049500149

Prizren : 18.03.2026

NJOFTOJ


Bashkëpronarin tim me pjesën ideale **Ali (Gani) Mulla 2/3** , si blers I interesuar unë si bashkëpronar me parcelën : **P-71813046-00816-2 ZK Lubizhdë Prizren** me pjesën time ideale të bashkëpronësisë **Erhan (Ismail) Mulla 1/3** po shes pjesën time ideale në tërësi .

Sipas rregulloreve ligjore për shitjen e pasurive të palujtshme është e nevojshme që filimisht të ofrohet shitja bashkëpronarit cili ka të drejtën e parablerjës në rase bashkëpronari nuk e blen pjesën time ideale athere shitja mund të bëhet me blerës të tjerë .

Me këtë ofroj bashkëpronarin tim nëse ai është I interesuar të blej pjesën time ideale të lajmrohet Brenda **30** ditëve të paguaj cmimin total I blerjes ne shumën prej **50.000 €** duke paguar me para në dorë / me para të gatshme .

Kontakt Telefon : 044410586

Prizren : 18.03.2026



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Maja Stohkovic shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi “ Prizren.

- Eliza Fanaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “ Heronjet e Lumes “ Vermic.

- Mirela Perteshi shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi “ Prizren.

- Bojlije Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Sezair Suroi “ Bellobrad.

- Besim Elshani shpall të pavlefshme certifikatat dhe diplomën e shkollës së mesme “Gjon Buzuku” Prizren.

- Muhamet Gashi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Drenica" Polac.

- Sadete Bajrami shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Azem Bejta" Prekaz.

- Fidan Peci shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 5-të të shkollës "Musa Hoti".

- Suna Haxhani shpall të pavlefshme dëftesën dhe diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani" Mitrovicë.

- Suzana Halimi shpall të pavlefshme dëftesën e vitit 4-të dhe diplomën e gjimnazit "Frang Bardhi".

- Neriman Mujka shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Frang Bardhi" Mitrovicë.

- “Magma Gaming Center” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812029016.

- “Blue’ IM 01” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812006907.

- Kjo iniciativë vjen si një shenjë vlerësimi dhe respekti për gratë, duke u ofruar atyre mundësi më të lehtë për t’u pajisur me patentë shoferi dhe për të fituar pavarësi në komunikacion.

- Për më shumë informata dhe regjistrime, të interesuarat mund të drejtohen pranë Auto Shkollës “Trimi” SH.P.K. gjatë orarit të punës.

Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës “Gjin Gazulli” Prishtinë.

Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh, profesionale “Dituria” Prizren.

Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Kuvendi i Juniku” Junik.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja
Ministry of Environment Spatial and Planning

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Plotësim Ndryshimin e Kushteve Ndërtimore nga EV WIND PARK SH.P.K. me nr. të protokolit 9090/25 të datës 22.12.2025 për parcelat kadastrale ku planifikohet të ndërtohet projekti " NËNSTACIONI EV WIND PARK ZATRIQ 1-35MW " me infrastrukturën përcjellëse që ndodhen në Zonën Kadastrale Zatriq me numër të parcelave: 01119-1, 01112-0 dhe 00530-1, 00544-0 në Komunën e Rahovecit.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e Plotësim Ndryshimin e Kushteve Ndërtimore për projektin " NËNSTACIONI EV WIND PARK ZATRIQ 1-35MW " për gjenerimin e energjisë elektrike bazuar në burim të ripërtëritshëm të energjisë, energji me erë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt.01.04.2026 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara:

Plotësim Ndryshimi I Kushteve Ndërtimore të propozuara: EV WIND PARK SH.P.K. projekti-" NËNSTACIONI EV WIND PARK ZATRIQ 1-35MW " Z.K. Zatriq - Komuna e Rahovecit"

Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:

a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Arë e klasës 7, 8 dhe Kullosë e klasës 5 dhe 6, Shfrytëzim i përkohshëm- Prodhim i Energjisë së Ripërtitshme nga Dielli

b. Vija rregulluese.	7.5 m' 27.5 m'
c. Vija e ndërtimit.	2.45 m' 10.11 m'

d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike

4.5 m'
9.72-18.69 m'

e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.

4.5 m'
67.01-90.82 m'

f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte

8.13 %

g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.

76.91 %

h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.

- %

i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.

- %

j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.

30

k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Struktura mbajtese beton-arme, konstruksioni i turbinave çelik. Mbulesa e nenstacionit me kulm te trafshet te pashfrytezueshem me shtresa izoluese
--	--

l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐
Nuk aplikohet ☐

m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth?
Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:

n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Ermbotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906
0.5L